



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:217975

Datë: 29.08.2024

Numri i dokumentit: 06100675

KF.nr.493/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me procesmbajtësen Arlinda Hyseni, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Matkos Pharm” sh.p.k, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sylejman Klinaku, avokat në Prishtinë, kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike anulim vendimi - Kundërvajtje Doganore, vlerë kontesti 500.00 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik, të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse Avokat Sylejman Klinaku, dhe përfaqësueses së autorizuar të palës së paditur Krenare Shala, me datë 31.07.2024 mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “Matkos Pharm” sh.p.k, me seli në Prishtinë, si e pa bazuar.
- II. Mbetet në fuqi Aktvendimi nr.01.3.2.2/702/2018 i dt.03.08.2021 i Doganës së Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës

A R S Y E T I M

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 29.09.2021 ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, kundër Aktvendimit nr.01.3.2.2/702/2018 të dt.03.08.2021, duke theksuar se e paditura nuk ka dhënë arsye të cilat vërtetojnë se paditësi me dashje ka deklaruar kodin tarifor 9018499000 me qëllim që të ikë nga pagesa e taksave dhe jo kodin tarifor 8543709090. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse ka deklaruar se: Mbesim në tërësi pranë

padisë dhe kërkesëpadisë, konsiderojmë që provat e dorëzuara në padi do të vërtetojnë faktet vendimtare edhe në këtë procedurë gjyqësore e cila rrjedh si pasojë e vendimeve për së dyti refuzuese të paditurës si dhe duke mos i marrë për bazë rekomandimet e gjykatës lidhur me kthimin në rivendosje të çështjes. Andaj, qëndrojmë fuqishëm edhe në këtë seancë se gjykata do të veproj komform dispozitave ligjore përkatëse, ashtu siç ka vepruar edhe në procedurën e mëparshme të kësaj çështje kontestuese. Ashtu siç është vërtetuar edhe më parë nga gjykata në aktgjykimin me A.nr.1434/2018 provat e dorëzuara të bashkangjitura në padi përveç tjerash prova e cila e kundërshton deklarin e të paditurës në këtë seancë është licenca e lëshuar nga AKPM se pajisja e tillë është pajisje medicinale dhe e njëjta nuk mund të përdoret në asnjë mënyrë për përdorim familjar apo privat sepse shkakton dëme të pariparueshme tek njeriu dhe është e dëmshme për shëndetin e njeriut. Andaj, kërkojmë nga gjykata që ta aprovoj në tërësi si të bazuar padinë dhe kërkesë padinë e paditësit si të bazuar në ligj, të anuloj vendimin me nr.01.3.2.2/702/2018 të datës 03.08.2021, detyrohet e paditura që të kthej edhe shumën e gjobës në vlerë prej 500.00 euro të paguar, po ashtu i kërkojmë edhe shpenzimet e procedurës dhe atë edhe 104.00 euro për përpilimin e padisë dhe përfaqësimin në seancë shumën prej 135.00 euro të gjitha sipas tarifës së OAK-ës si dhe taksën gjyqësore prej 50.00 euro sipas UA të KGJK-ës për taksë gjyqësore.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 27.10.2021 e ka kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se aktvendimi është marr konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, ngase vendimi i kontestuar është marrë komfor legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e autorizuar e palës së paditur ka deklaruar se: E paditura e konteston në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Paditësi është shpallur përgjegjës vepër kundërvajtëse për shkak se nuk ka deklaruar saktë kodin tarifor për mallin-pajisje dentare- zbardhues i dhëmbëve, i cili mall e ka deklaruar kodin tarifor 9018499000 që liron nga taksë 10% ndërsa përshkrimi i duhur duhet të jetë llampa për zbardhje të dhëmbëve që i nënshtrohet taksës prej 10% dhe me kod tarifor të duhur 8543709090. Sektori i Tarifës sqaron se nuk kemi të bëjmë me pajisje mjekësore por me pajisje elektrike që ka funksion individual jo i specifikuar dhe i përfshirë diku tjetër, pajisje që përdoren në kozmetikë për përsheptimin e zbardhjes së dhëmbëve të kreut 8543. Për tu shmangur nga përgjegjësia ligjore paditësi është dashur ti ndërmarr veprimet sipas dispozitave të nenit 106 UA11/2009 për zbatim të KDA-ës. I padituri në ankesat drejtuar Doganës

vazhdimisht ka kontestuar vendimin e Sektorit të kundërvajtjes e jo edhe ndryshimin/ndërrimin e kodit tarifor, andaj, bazuar në të cekurat si më lartë e paditura i propozon gjykatës që të refuzoj në tërësi si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe të lënë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm dhe të drejtë. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 31.07.2024, ka administruar provat dhe atë: Aktvendimin 01.3.2.2/702/2018 e datës 03.08.2021, Licencën nr.A-1951/17 A-0271/17 së bashku me formularët PM-10-2015, Aplikacionin për pajisje medicinale të datës 17.07.2017, 09.02.2017, Aktvendimin 03.1.7-2017-548/08.09.2017, Përgjigjen në padi, Procesverbalin mbi kundërvajtjen doganore, Mendimi për klasifikimin tarifor nr.111/11.09.2014, Aktvendimin 702/15.02.2018, Aktvendimin 702/22.02.2018, Ankesën e ushtuar në Doganë të datës 18.10.2017, Letrën informative të Doganës e datës 15.12.2017 dhe Pro faturën e datës 19.12.2016.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi dhe seancë, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar - administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar - administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ, deklarimeve në ankesë, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestues fakti se Sektori për Kundërvajtje Doganore me Aktvendimin 03.1.7-2017-548 të datës 08.09.2017, e ka shpallur përgjegjës këtu paditësin për kundërvajtje doganore nga neni 276 pika k) të KDA-së. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi ka ushtuar ankesë pranë Doganës së Kosovës, e për të cilën ankesë, Dogana e Kosovës me datë 03.08.2021, ka sjell Aktvendimin nr. 01.3.2.2/702/2018, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar kërkesën e subjektin në procedurë, e kundër të cilit, paditësi me padinë e datës 29.09.2021, ka iniciuar kontestin tregtar - administrativ pranë kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës në shkallë të dytë e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë këtu paditësit, të ushtruar ndaj aktvendimit 03.1.7-2017-548 të datës 08.09.2017 të Sektorit për Kundërvajtje Doganore, si të pabazuar. E paditura ka vlerësuar se Sektori për Kundërvajtje Doganore ka vepruar drejtë kur subjektin ankimor “Matkos Pharm” sh.p.k, e ka shpallur paditësin përgjegjës për kundërvajtje doganore nga neni 276 pika k) të KDA-së, për shkak se nuk ka deklaruar saktë kodin tarifor me anë të deklaratës R-5468/14.03.2017 për mallin “Pajisje dentare-zbardhuese i dhëmbëve”, të cilin mall e ka deklaruar në kodin doganor 9018499000, i cili kod e liron mallin nga taksa doganore prej 10%, ndërsa parashkrimi i duhur i mallit duhet të jetë “llamba për zbardhje të dhëmbëve”, dhe kodi i duhur tarifor duhet të jetë 8543709090 (mendimi tarifor: 04.3/111 datë 11.09.2014), sipas të cilit kod duhet të paguaj taksën doganore prej 10 %, ku me këtë veprim i është shmangur taksave doganore në vlerë prej 346.44 €. Andaj, në këtë mënyrë ka vepruar me qëllim që të paguaj taksë doganore në kundërshtim me nenin 276 pika k) të Kodit Doganore dhe të Akcizave të Kosovës Nr.03/L-109, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-099, ku thuhet se *“Në qoftë se, në Deklaratën Unike Doganore në mënyrë të rrejshme, të pasaktë apo jo të plotë shënon sasinë, cilësinë, llojin, kodin tarifor, vlerën apo origjinën e mallit ose nuk e përfshin tërë mallin, që ka rezultuar me llogaritjen ose pagesën e borxhit doganor në shumë më të vogël nga ajo reale, do të gjobitet me gjobë në të holla në shumë prej pesëqind (500.00) deri në dhjetëmijë (10,000.00) Euro.*

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative. Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, ne vështrim të nenit 44 të LKA-së. Gjykata nuk ka mundur t’i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor kryesor sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Pretendimi i paditësi se i njëjti ka ofruar prova të mjaftueshme, përkatësisht dokumente që e argumentojnë mjaftueshëm se pajisja në fjalë është pajisje dentare dhe që përdoret vetëm në Ordinanca Stomatologjike dhe assesi nuk përdoret si zbardhues i dhëmbëve në ekonomitë tona familjare, për Gjykatën është i pa bazuar dhe në kundërshtim edhe me shkresat e lëndës dhe atë

me procesverbalin mbi kundërvajtjen administrative doganore nr.03.1.7-2017-548/24.07.2017, për faktin se paditësi në bazë të Mendimit për Klasifikim Tarifor nr.111/11.09.2014 nuk rezulton të ketë paraqitur dhe deklaruar kodin e saktë tarifor, e që ka rezultuar me llogaritjen ose pagesën e detyrimeve doganore më pak se sa vlera e llogaritur e mallit me kodin tarifor të ndryshuar 8543709090, e i cili kod tarifor përfshin edhe taksën doganore prej 10%. Tutje Gjykata ka gjetur se i njëjti mall me të njëjtën vlerë në të cilën është kalkuluar edhe taksa doganore prej 10% për shkak të ndërrimit të kodit tarifor është proceduar tutje si e tillë në Zyrën Doganore Prishtinë, dhe atë me deklaratën unike doganore R-5468/14.03.2017, e cila deklaratë doganore nuk është kontestuar nga paditësi në padi dhe as në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor.

Gjykata në kuptim të lartësisë së gjobës ka gjetur se e njëjta nuk është kundërshtuar nga ana e palës paditëse, ndërsa në anën tjetër e njëjta është arsyetuar mjaftueshëm nga ana e palës së paditur në aktvendimin kontestues dhe aktvendimin 03.1.7-2017-548 të datës 08.09.2017, andaj edhe nuk është lëshuar më tutje në vlerësim dhe elaborim të së njëjtës.

Gjykata vlerëson se nga gjendja faktike e vërtetuar si më lartë dhe bazuar në dispozitën e nenit 276 pika k) të Kodit Nr.03/L-109, ku thuhet se *“Personi juridik apo fizik: është përcaktuar qartë se “Në qoftë se, në Deklaratën Unike Doganore në mënyrë të rrejshme, të pasaktë apo jo të plotë shënon sasinë, cilësinë, llojin, kodin tarifor, vlerën apo origjinën e mallit ose nuk e përfshin tërë mallin, që ka rezultuar me llogaritjen ose pagesën e borxhit doganor në shumë më të vogël nga ajo reale”, do të gjobitet me gjobë në të holla në shumë prej pesëmijë (5.000) deri në dhjetëmijë (10.000) €”*. Tutje sipas Ligji Nr. 04/1-099 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosovë Nr.03/L-109, neni 9 paragrafi 2 përcakton se *“Neni 276 i ligjit bazik, pas pikës z). shtohet pika e re: zh). me tekstin si në vijim: zh). për të gjitha shkeljet e parapara në nenin 276, do të gjobitet me gjobë në të holla në shumë prej pesëqind (500) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro”*, është aplikuar si duhet e drejta materiale nga e paditura, duke dhënë arsye dhe sqarime të mjaftueshme në aktet e kundërshtuara për secilën pikë veç e veç, dhe të gjitha së bashku.

Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj, rrjedhimisht në këtë kuptim gjykata vlerëson se paditësi nuk ka arritur të mbështes me prova pretendimet e tij në padi ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 7 par.1 dhe 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr.

03/L-006 parasheh se: “*Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*”. Neni 43, par 1. I LKA-së, “*Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative*”, andaj paditësi në këtë kontest tregtar - administrative ka dështuar që të prezantojë provat me të cilat do të mbështet pretendimet e tij në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Gjykata erdhi në përfundim se në këtë kontest tregtar - administrativ drejtë është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj thëniet e padisë nuk i aprovoj sepse i vlerësoj të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuara nga e paditura.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur komfor nenit 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata komfor dispozitave ligjore të 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.493/22 datë 31.07.2024

Procesmbajtëse
Arlinda HYSENI

Gj y q t a r i
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.